



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 44
Prishtinë, më 12.04.2019, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Sërgjan Mitrovliq.

Pjesëmarrës të tjerë: Agonis Thaçi, D+.

Stafi mbështetës i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Vjosa Osmani Sadriu njoftoi se në mbledhjen e kaluar është prezantuar projektligji nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Propozoi që projektligji t'i kthehet Qeverisë me specifika konkrete se cili duhet të jetë ndryshimi në atë ligj, dhe t'i jepet një afat kohor, brenda se cilit Qeveria ta riprocedojë ligjin. Njoftoi se propozimi për t'ia kthyer projektligjin, Qeverisë, ka të bëjë me nenin 85, i cili e prish rrjedhën e ligjit dhe bie në kundërshtim me kërkesat e vazhdueshme të komisionit për depolitizimin e shërbimit të jashtëm, dhe se edhe përfaqësuesit e MPJ-së e kanë pranuar që ai nen mund të krijojë paqartësi. Ajo më tej shtoi se nëse komisioni e kalon në parim projektligjin me atë nen, atëherë do të jetë shumë vështirë të miratohet si amendament shkaku i rrethanave që janë për momentin në parlament.

Elmi Reçica tha se komisioni në mbledhjen e kaluar e ka trajtuar dhe ka diskutuar për këtë çështje dhe se është dakorduar për ta miratuar në parim këtë projektligj. Ai propozoi që të miratohet në parim, pastaj të vazhdohet me procedurat tjera. Reçica kërkoi që të vijnë përfaqësuesit e MPJ-së edhe një herë dhe nëse mund t'i bindim ta tërheqin ata projektligjin, nëse jo atëherë vazhdojmë me amendamentimin e tij.

Time Kadrijaj shprehu mendimin se meqenëse ka një unitet në komision, projektligji nuk ka nevojë që për një amendament t'i kthehet Qeverisë, për t'iu nënshtruar prapë procedurave në

Qeveri. Ajo shtoi se komisioni ka të drejtë ta ndryshojë projektligjin si dhe propozoi që komisioni ta miratoi në parim projektligjin në mënyrë që t'i jepet një mundësi që të kalojë në seancën plenare, ndërsa pas miratimit të punohet në këtë projektligj, ashtu që ky projektligj të jetë një ligj i mirë dhe i zbatueshëm.

Vjosa Osmani Sadriu, tha se pajtohet me deputeten Kadrijaj që në rrethana normale më së mirë është që ndryshimet të bëhen në mes të dy leximeve, por për shkak të rrethanave në Kuvend mund të stërzgjetet dhe të komplikohet kjo punë. Ajo më tej shtoi se do të ishte më e lehtë nëse MPJ e kthen mbrapa projektligjin dhe brenda javës e bënë ndryshimin në nenin 4 dhe nenin 85. Nëse rregullohen këto dy çështje, tha se atëherë do ta kenë më lehtë të insistojnë që të marrin pjesë në votim.

Time Kadrijaj propozoi që projektligji të hidhet në votim për miratimin në parim, sepse komisioni ka mundësi t'i ndryshojë elementet për të cilat po flitet gjatë amendamentimit të tij.

Dukagjin Gorani tha se është dakord që të votohet projektligji në parim, me largimin e nenit 4.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-154 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, t'i kthehet Qeverisë.
2. Kërkohet nga Qeveria që neni 4 i Projektligjit të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe neni 85 të specifikojë qartë se procesi i vlerësimit të diplomatëve ka të bëjë me diplomatët e karrierës.
3. Projektligji me plotësimet e kërkuara nga Komisioni të rikthehet në procedim në Kuvend brenda një jave.

Për këtë rekomandim nga 10 deputetë të pranishëm, "për" votuan 6 deputetë, "kundër" votuan 4 deputetë.

Elmi Reçica njoftoi se ne jemi dakorduar që do ta votojmë ligjin në parim, ashtu siç është rregulli, pastaj janë procedurat tjera. Njoftoi se ky projektligj në legjislaturën e kaluar është tërhequr dhe vetëm tani i është proceduar Kuvendit, dhe se nuk i bënë nder Kuvendit nëse tërhiqet nga procedura.

Vjosa Osmani Sadriu tha se çështja e votimit ka qenë për me hedhur në votim, dhe i takon secilit deputet në komision të votojë sipas vullnetit të tij. Ajo shtoi se Qeveria mund të ketë vullnet për ta rikthyer këtë ligj shumë shpejt, pasi që janë në pyetje vetëm dy nene.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.